



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 03.06.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkeses për ri-shqyrtim** të datës **28.05.2025** të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Tretek SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Mirëmbajtja dhe avancimi i web faqes zyrtare të MSh-së"** me numër prokurimi; **206-25-1914-2-2-1**, Nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET**, kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik **Tretek SH.P.K.**, e datës 28.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Mirëmbajtja dhe avancimi i web faqes zyrtare të MSh-së"** me numër prokurimi; **206-25-1914-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 28.05.2025 te publikuar ne platformën elektronike.
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK, i datës 28.05.2025;
- III. Autoriteti Kontraktues, e konsideron te anuluar aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatoret Ekonomik **Tretek SH.P.K.**, ka parashtruar kerkese per rishqyrtim per AP me titull **"Mirëmbajtja dhe avancimi i web faqes zyrtare të MSh-së"** me numër prokurimi; **206-25-1914-2-2-1**. Autoriteti Kontraktues, me datë 03.06.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

Pretendimet Ankimore te OE ankues:

Ne, kompania **TRETEK SH.P.K.**, duke vepruar si OE i interesuar dhe pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me referencë Nr. 206-25-1914-2-2-1, me titull “**Mirëmbajtja e Ueb-faqes së MSh-së (Mundësimi i qasjes për personat e shurdhër dhe të verbër në faqen zyrtare të MSh-së)**”, kemi paraqitur tenderin tonë brenda afatit të përcaktuar dhe në përputhje me të gjitha kërkesat teknike, ligjore dhe procedurale të përcaktuara në dokumentacionin përkatës të tenderit.

Pavarësisht përmbushjes së të gjitha kriterëve dhe faktit që jemi paraqitur si **ofertuesi i vetëm**, jemi njoftuar për **anulimin e aktivitetit të prokurimit**, bazuar në një rrethanë të **mëvonshme** lidhur me përgjegjësitë e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) ndaj ueb-faqeve të institucioneve qeveritare.

Ky vendim për anulim ka ardhur në një fazë të finale të procesit, pas dorëzimit të ofertës sonë të plotë dhe brenda afatit zyrtar të shtyrë. Në këtë kuadër, ne konstatojmë këto pika gjatë këtij procesi të prokurimit.

TRETEK SH.P.K. ka dorëzuar një ofertë të rregullt dhe të pranueshme, me çmim konkurrues nën vlerën e parashikuar të kontratës.

- Aktiviteti është anuluar, bazuar në një **sqarim të mëvonshëm nga ASHI** për ndarjen e kompetencave në mirëmbajtjen e faqeve qeveritare.
- Ky **anulim është bërë pa asnjë paralajmërim në fazën fillestare**, pavarësisht se autoriteti kontraktues kishte vazhduar të plotësojë të gjitha hapat proceduralë deri në afatin final të ofertimit.
- Të ndodhur përballë një vendimi të njëanshëm, që ka krijuar jo vetëm **pasiguri ligjore**, por edhe **dëm material dhe kohor të dokumentueshëm**.

Kësisoj:

Vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ashtu siç është paraqitur në njoftimin zyrtar të datës 28.05.2025, ngre shqetësime të thella lidhur me përputhshmërinë e tij me parimet të prokurimit publik, siç përcaktohen në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (me plotësim ndryshimet) dhe Rregulloren për Prokurimin Publik sepse këtu kemi të bëjmë me:

· Mungesë transparence:

Ju si AK nuk na keni informuar për ndonjë proces të ri të brendshëm të koordinimit institucional me ASHI-në, pas shtyrjes së afatit sipas “B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara”

Kjo mungesë e transparencës ka ndikuar që ne, si OE dorëzuam ofertë, të shpenzojmë në përgatitjen e dokumentacionit, në një situatë që do të kishte duhej të ishte sqaruar paraprakisht nga AK, para dorëzimit të ofertave.

· Shkaktim i dëmit material:

Vendimi për anulim është marrë në fazën pas dorëzimit të ofertës. Gjatë kësaj periudhe, TRETEK ka angazhuar staf teknik dhe juridik, ka zhvilluar ofertë të plotë për nevojat e kontratës dhe ka përballuar kostot financiare për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës. Ky angazhim real dhe i dokumentueshëm përbën **dëm material**.

· Anulimi është kundër rregullores së Prokurimit Publik:

Sipas **nenit 43.5 të Rregullores së Prokurimit Publik**, një aktivitet i prokurimit mund të anulohet pas afatit për dorëzimin e ofertave vetëm në rrethana të kufizuara dhe objektive, si:

Në rastin konkret, **asnjë prej këtyre kushteve nuk është përmbushur**. Përkundrazi, ka ekzistuar një ofertë e vlefshme, e vetmja në këtë procedurë, e cila e përmbushte tërësisht kërkesat e publikuara.

Për më tepër, justifikimi që ASHI do të marrë përsipër këtë shërbim në të ardhmen, nuk përbën bazë të mjaftueshme ligjore për anulimin e një aktiviteti tashmë të zhvilluar dhe të konkretizuar deri në fundin e fazës së ofertimit.

Andaj, duke u bazuar në pretendimet e lartpërmendura, kërkojmë nga AK-ja që të pranojë kërkesën për rishqyrtim si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës si dhe përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Këto shpenzime përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Shpenzimet për përgatitjen e ofertës: Këto përfshijnë kostot për hartimin e dokumenteve, analiza të nevojshme për përgatitjen e ofertës, konsulta ligjore dhe shpenzimet administrative që kanë ndodhur gjatë periudhës përgatitore.
- Shpenzimet për përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim: Këto përfshijnë kostot për hartimin e kërkesës, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e kërkesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.
- Fitimet e pritura: Në përputhje me ofertën e bërë, ne kishim parashikuar fitime të caktuara nëse do të shpallej fituesi i procedurës së prokurimit. Eliminimi i papranueshëm nga procedura ka rezultuar në humbjen e mundësisë për të realizuar këto fitime.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

E kemi shqyrtuar Kërkesa tuaj për rishqyrtim, pretendimet e juaja ankimore dhe duke marrë parasysh rrethanat e krijuara që janë jashtë kompetencave të Div. të Prokurimit, nuk mund ta pranojmë kërkesën tuaj por detyrohem të refuzojmë, bazuar në dispozitat ligjore si në vijim:

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, **duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.**

Bazuar në paragrafin 1.1 të nenit 62 të LPP-se, është krijuar rrethana e pa parashikuar gjatë procesit të këtij aktiviteti, fillimisht ne e kemi shtyrë afatin për ofertim duke shprehur që mund të kemi një përgjigje pozitive nga ASHI dhe ta realizojmë projektin, por pas hapjes së ofertave, në procesin e vlerësimit të ofertës, e kemi pranuar konfirmimin e ASHI-se me shkrim se:

"Çdo aktivitet që ka të bëjë me zhvillimin ose mirëmbajtjen e ueb-faqeve është duke u realizuar nga ana e ASHI-së. Ndërsa vlen të ceket se të gjitha projektet që lidhen me teknologji informative duhet të pari të kalojnë për shqyrtim dhe aprovimin nga komisioni i ASHI-së, për t'u siguruar që do të përmbushen të gjitha kërkesat teknike dhe për të shmangur krijimin e dyfishtë të projekteve të njëjta.

Ne, si ASHI, do të mbulojmë nevojat tuaja për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e ueb-faqes së Ministrisë së Shëndetësisë dhe agjencive vartëse".


Pas takimeve te mbajtura ne mes MSH dhe ASHI dhe njoftimit te dhene nga ASHI, nga Njesia e Kerkeses ne MSH jemi njoftuar me shkrim per anulimin e aktivitetit, me arsyetimin se:

“Bazuar në njoftimin e ASHI-së, është e qartë se ASHI, si autoritet, ka përgjegjësinë për mirëmbajtjen e ueb-faqeve zyrtare të institucioneve të nivelit qeveritar. Në këtë kontekst, aktiviteti i prokurimit për mirëmbajtjen dhe avancimin e ueb-faqes së Ministrisë duhet të anulohet, pasi ky aktivitet përbën një duplikim”.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit